

## AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Bita-Union" SHPK

Sot. ne Kavaje me date 12/09/2023, diten e marte, u mblodhen ortaket e shoqerise "BITA-UNION" shpk:

#### **THEMELUESI/T:**

1-ALBITA SHABA, e bija e Vahidit, e dtl 05.09.1996, banuese e lagjes Nr.5, rruga "Abdurrahim Sedja", Kavaje, identifikuar me Nr. leternjoftim 037740242 dhe Nr. personal J65905095T. Duke u mbeshetur ne ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare", me ndryshimet e mevonshme, vendosem te themelojme Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, sipas kushteve vijuese:

#### KREU I

### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

#### **NENI 1**

#### **OBJEKTI I SHOQERISE**

- 1.1 Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj: **Veprimtaria financiare e kembimeve valutore.**

#### **NENI 2**

#### **EMERTIMI, SELIA JURIDIKE E SHOQERISE**

- 2.1 Ortaket kane vendosur qe te themelojne kete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin : **"Bita-Union" shpk.** (Me poshte e quajtur shoqeria).
- 2.2 Selia e Shoqerise ndodhet ne lagjen nr.2, zk 8551, nr pasurise 16/266+1-2/2, Kavaje.

#### **NENI 3**

#### **REGJIMI JURIDIK**

- 3.1 Shoqeria eshte SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR. Aktiviteti i saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit te Shoqerise dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 3.2 Me vendimin e Ortakeve te Shoqerise, Ortaket mund te ndryshojne Regjimin Juridik te Shoqerise, nese ne te ardhmen krijohen premisa te favorshme per funksionimin e saj, sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket duhet te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise dhe te bejne regjistrimin e ndryshimeve ne Regjistrin Tregtar, prane organit kopetent shqiptar.
- 3.3 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, ose Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) ne perputhje me ligjin.
- 3.4 Shoqeria do te kete vullen e saj e cila do te permbaje dhe emrin e shoqerise **"Bita-Union" shpk.**

**KREU II**  
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET, AFATI**

**NENI 4**  
**TE DREJTAT E SHOQERISE E ORTAKUT**

- 4.1 Shoqeria gezon te drejten te lidhe marreveshje dhe kontrata te ndryshme, ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
- 4.2 Shoqeria gezon te drejten te zhvilloje (krijoje) pronesi materiale dhe intelektuale.
- 4.3 Shoqeria ka te drejte te marre pjese, si ortak ne shoqeri apo nderrmarrje te tjera, brenda ose jashte territorit te Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4 Shoqeria mban pergjegjesi ndaj te treteve, vetem dhe ekskluzivisht, me kapitalin e saj te derdhur dhe te mirat materiale nga pasuria e saj.
- 4.5 Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informacionet ne raport me aktivitetin prodhues, projektues, te realizimeve tregtare te shoqerise, si bilanci, llogarite ekonomike, etj.
- 4.6 Ortaket kane te drejte te emerojne apo shkarkojne, Administratorin ose Administratoret, Punojes te shoqerise, Ekspertin kontabel, Likuidator.

**NENI 5**  
**AFATI (KOHEZGJATJA)**

- 5.1 Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje afat te pacaktuar.

**KREU III**  
**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

**NENI 6**

- 6.1 Kapitali themeltar I Shoqerise eshte ne shumen 2.500.000 (dy milion e peseqindmije) leke dhe aktualisht eshte i ndare ne nje kuote te vetme.
- 6.2 Nje kuote me vlere 2.500.000 leke, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise, zoterohet nga z. Ermal Shehi.
- 6.3 Pergjegjesia e ortakeve/ortakut per detyrimet e shoqerise shtrihen deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit ortak ne kapitalin e shoqerise.
- 6.4 Kapitali do te derdhet ne para cash ne banke.

**KREU IV**  
**ORGANET E SHOQERISE**

**NENI 7**

- 7.1 Vendimet e Shoqerise merren nga Ortaket e shoqerise, ne Asamblene e Pergjithshme.
- 7.2 Administratori i Shoqerise dhe eventualisht Eksperti Kontabel do te caktohet e ngarkohet nga Ortaket e Shoqerise.



**KREU V**  
**ADMINISTRIMI**

**NENI 8**

- 8.1 Pasuria,veprimtaria dhe aktiviteti i shoqerise do te administrohen nga administratori i emeruar dhe i caktuar nga asambleja e ortakeve te shoqerise,(ortakut te vetem) znj.Albita Shaba,per nje afat 5 vjecar nga data e ketij akti.
- 8.2 Administratori do te rimburohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij.
- 8.3 Administratori do te ushtroje kompetencat e tij deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:  
-largimin e tij  
-dhe perfundimi i afatit 5 vjecar nga data e fillimit te ketij akti,nese mandati nuk eshte rinovuar

**KREU VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**NENI 9**

- 9.1 Fitimi i realizuar i Shoqerise,pas likuidimit te detyrimeve ligjore,do te ndahet midis ortakeve te shoqerise (ne kete rast ortaku I vetem),nga ku znj.Albita Shaba merr 100% te fitimit.
- 9.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt Themelimi,per cdo paqartesi apo mosmarreshje,vlejne dispozitat e ligjit 9901,date 14.04.2008 me ndryshimet e mevonshme "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 9.3 Aky akt perpilohet e nenshkruhe ne tre kopje me te njejten vlere ligjore,nga ku nje kopje do te qendroje ne dokumentacionin baze te shoqerise.
- 

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**  
**NE KETE RAST ORTAKU I VETEM**

**ALBITA SHABA**

Albita Shaba

Vok